Instituti i Statistikave
Rr. Vllazën Huta,
Ndërtesa 35, Hyrja 1
Tiranë, Kodi Postar 1017

info@instat.gov.al
www.instat.gov.al
Tel: +355 4 2222 411
Faks: +355 4 2222 411

# Aksidentet Rrugore

## Korrik 2019

**Tiranë, më 21 Gusht 2019:** Në muajin Korrik 2019 numërohen 148 aksidente rrugore nga 166 aksidente të ndodhura në muajin Korrik 2018, duke u ulur me 10,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Në shtatëmujorin e parë 2019, numërohen 862 aksidente rrugore nga 967 aksidente të ndodhura në shtatëmujorin e parë 2018, duke u ulur me 10,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Fig. 1 Aksidentet rrugore mujore, Korrik 2015 – Korrik 2019




**Burimi**: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Në muajin Korrik 2019, numri i të aksidentuarve (të vrarë dhe të plagosur) është 228 persona nga 210 që ishte një vit më parë duke u rritur me 8,6 %. Numri i të aksidentuarve në shtatëmujorin e parë të vitit 2019 është 1.188 persona nga 1.279 persona, duke u ulur me 7,1 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018.

Në muajin Korrik 2019, numri i të vdekurve nga aksidentet rrugore është 13 persona nga 18 persona të vdekur në Korrik 2018. Në shtatëmujorin e parë 2019, numri i të vdekurve nga aksidentet rrugore është 115 persona nga 116 persona, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

**Për publikim 21/08/2019**

*Vijon*

Në muajin Korrik 2019, aksidentet rrugore, në 89,9 % të rasteve, kanë ndodhur si pasojë e sjelljes së drejtuesit të mjetit. Numri më i lartë i aksidenteve në këtë periudhë është kryer nga grup mosha 25 –35 vjeç, duke zënë 30,4 % të numrit të aksidenteve gjithsej. Aksidentet në këtë grup moshe janë rritur me 15,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Në shtatëmujorin e parë 2019, aksidentet rrugore, në 13,5 % të rasteve, kanë ndodhur si pasojë e sjelljes së këmbësorit. Gjatë kësaj periudhe, numri i aksidenteve sipas sjelljes së këmbësorit është ulur 42,3 %, krahasuar me një vit më parë.

### Tab. 1 Aksidentet rrugore

| Periudha | Aksidente Gjithsej | Të vdekur Femra | Të vdekur Meshkuj | Të plagosur Femra | Të plagosur Meshkuj |
|---|---|---|---|---|---|
| Korrik-2018 | 166 | 2 | 16 | 64 | 128 |
| Korrik-2019 | 148 | 3 | 10 | 75 | 140 |
| **Ndryshimi vjetor (%)** | **-10,8** | **50,0** | **-37,5** | **17,2** | **9,4** |
| Janar–Korrik 2018 | 967 | 26 | 90 | 373 | 790 |
| Janar–Korrik 2019 | 862 | 36 | 79 | 322 | 751 |
| **Ndryshimi vjetor progresiv (%)** | **-10,9** | **38,5** | **-12,2** | **-13,7** | **-4,9** |

**Burimi**: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

### Tab 2 Aksidentet rrugore, sipas përdoruesve të rrugës

| Periudha | Aksidente sipas Sjellja e Drejtuesit të Mjetit | Aksidente sipas Sjellja e Këmbësorëve | Të vdekur Sjellja e Drejtuesit të Mjetit | Të vdekur Sjellja e Këmbësorëve |
|---|---|---|---|---|
| Korrik-2018 | 123 | 43 | 11 | 7 |
| Korrik-2019 | 133 | 15 | 12 | 1 |
| **Ndryshimi vjetor (%)** | **8,1** | **-65,1** | **9,1** | **-85,7** |
| Janar –Korrik 2018 | 766 | 201 | 88 | 28 |
| Janar –Korrik 2019 | 746 | 116 | 105 | 10 |
| **Ndryshimi vjetor progresiv (%)** | **-2,6** | **-42,3** | **19,3** | **-64,3** |

**Burimi**: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

## Tab. 3 Aksidentet rrugore, sipas moshës së drejtuesit të mjetit

| Periudha | 0 - 25 vjeç | 25- 35 vjeç | 35- 45 vjeç | 45-60 vjeç | 60+ vjeç | Larguar nga vendi i ngjarjes |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Korrik-2018 | 27 | 39 | 30 | 45 | 12 | 13 |
| Korrik-2019 | 28 | 45 | 32 | 27 | 10 | 6 |
| Ndryshimi vjetor (%) | **3,7** | **15,4** | **6,7** | **-40,0** | **-16,7** | **-53,8** |
| Janar–Korrik 2018 | 199 | 264 | 167 | 200 | 72 | 65 |
| Janar–Korrik 2019 | 181 | 253 | 163 | 164 | 62 | 39 |
| Ndryshimi vjetor progresiv (%) | **-9,0** | **-4,2** | **-2,4** | **-18,0** | **-13,9** | **-40,0** |

**Burimi**: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

## Tab. 4 Aksidentet rrugore sipas qarqeve

| | Aksidente | | Të vdekur | | Aksidente | | Të vdekur | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Periudha | Korrik 2018 | Korrik 2019 | Korrik 2018 | Korrik 2019 | Janar-Korrik 2018 | Janar-Korrik 2019 | Janar-Korrik 2018 | Janar-Korrik 2019 |
| **Shqipëria** | **166** | **148** | **18** | **13** | **967** | **862** | **116** | **115** |
| Tiranë | 71 | 57 | 5 | 6 | 432 | 373 | 26 | 31 |
| Durrës | 26 | 8 | 1 | 1 | 128 | 68 | 12 | 14 |
| Shkodër | 4 | 3 | 1 | 1 | 20 | 15 | 15 | 12 |
| Elbasan | 15 | 9 | 5 | 1 | 68 | 50 | 17 | 10 |
| Fier | 11 | 14 | 3 | 2 | 64 | 69 | 15 | 15 |
| Vlorë | 18 | 12 | 0 | 0 | 64 | 57 | 2 | 4 |
| Korçë | 5 | 21 | 2 | 0 | 44 | 61 | 4 | 10 |
| Lezhë | 7 | 15 | 0 | 1 | 74 | 90 | 10 | 7 |
| Berat | 1 | 0 | 1 | 0 | 26 | 13 | 3 | 2 |
| Kukës | 2 | 2 | 0 | 1 | 10 | 23 | 5 | 4 |
| Dibër | 2 | 0 | 0 | 0 | 17 | 6 | 4 | 4 |
| Gjirokastër | 4 | 7 | 0 | 0 | 20 | 37 | 3 | 2 |

**Burimi**: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

# Metodologjia

Qëllimi i publikimit mujor të aksidenteve është paraqitja e rezultateve dhe treguesve mbi aksidentet rrugore si: ndryshimin në numrin e aksidenteve mujore, numrit të personave të vrarë dhe të plagosur nga aksidentet rrugore të klasifikuar sipas gjinisë, sjelljes së përdoruesve të rrugës, moshës dhe qarqeve në vend duke e krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit është institucioni i cili i siguron INSTAT-it një sistem të gjerë informacioni lidhur me aksidentet rrugore.

**Përkufizime**

**Aksidente:** Ngjarje e papritur e padëshiruar ose e paqëllimshme ose një zinxhir specifik ngjarjesh të tilla që sjellin pasoja të dëmshme.

**Aksident me pasoja:** Çdo aksident që përfshin të paktën një automjet në lëvizje, duke rezultuar në të paktën një person të vrarë ose të dëmtuar. Aksidentet në vendin e punës, depo janë të përjashtuara.

**I vdekur:** I vdekur nga aksidenti në rrugë quhet çdo person i cili ka vdekur menjëherë ose brenda 30 ditëve si rezultat i aksidentit,

**I plagosur:** I plagosur konsiderohet çdo person, i cili nuk ka vdekur por ka marrë plagë të lehta apo të rënda si rezultat i aksidentit,

**Sjellja e Drejtuesit të Mjetit :** Nënkupton nëse drejtuesi i mjetit nuk zbaton rregullat e qarkullimit rrugor sipas "Kodit Rrugor" si: frenim i papritur, mosrespektimi i shenjave (sinjalistikës) së trafikut, mosrespektimi i normave të shpejtësisë, etj,

**Sjellja e Këmbësorëve:** Nënkupton nëse këmbësori nuk zbaton rregullat e qarkullimit rrugor sipas "Kodit Rrugor" si : kalim rruge pa kujdes, etj,

**Burimi i të dhënave:** Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Punëve të Brendshme/Drejtoria e Policisë së Shtetit.

*Të dhënat e muajit të fundit mbi Personat e vdekur nga aksidentet rrugore janë paraprake dhe subjekt rishikimi,Për më shumë, referohu: Politika e revizionimit statistikor*